



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË
DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 222/prot.
18

Tiranë, më 30.08. 2020

RELACION

Lënda: Mbi raportet e monitorimit për 8-mujorin e vitit 2020

Bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ligjin nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.3.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, është kryer monitorimi i zbatimit të buxhetit për Institucionin e Komisionerëve Publikë për periudhën janar - gusht 2020, në kuadër të një analize krahasimore plan-fakt, sa i përket produkteve të përcaktuara dhe zërave të shpenzimeve, si dhe planifikimit të buxhetit në Projektbuxhetin Afatmesëm (2020-2022).

Në vijim paraqitet në mënyrë të përmbledhur, analiza e përdorimit të fondeve buxhetore për 8-mujorin e vitit 2020, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë me ata të planifikuar.

Në mijë lekë

Emërtimi	Buxheti vjetor	Buxheti vjetor i rishikuar	Buxheti, plani 8 - mujor	Realizimi 8 - mujor	Realizimi në %
Shpenzime korente	66,350	66,050	46,750	41,747	89,3%
Shpenzime kapitale	1,000	1,000	1,000	118	11.8%
TOTALI	67,350	67,050	47,750	41,865	87.7%

Fondet buxhetore të akorduara nga buxheti i shtetit për vitin 2020 në shpenzime korente dhe shpenzime kapitale janë 67,350 mijë lekë, ndërsa buxheti i rishikuar arriti në nivelin 67,050 mijë lekë.

Performanca e realizimit të fondeve buxhetore për periudhën 8-mujore është në nivelin 88%, nivel i cili është kushtëzuar nga situata e pandemisë COVID-19, që ka shkaktuar mospërdorimin e fondeve të akorduara, në shpenzime operative dhe shpenzime kapitale. Në muajt mars, prill, maj, sipas udhëzimeve të MFE-së dhe APP-së, janë pezulluar procedurat e blerjeve për mallra dhe shërbime, duke u dhënë prioritet vetëm shpenzimeve për energji elektrike dhe ujë, si dhe blerjeve të materialeve që kanë lidhje me pandeminë.

Në vijim, gjatë periudhës qershor - gusht, në kushtet e pandemisë COVID-19, Institucioni i Komisionerëve Publikë ka rivlerësuar nevojat në shpenzime operative dhe investime, duke i reduktuar ato në nivelin minimal të shpenzimeve më të domosdoshme për funksionimin e aktivitetit, kryesisht shpenzime për materiale, pajisje dhe shërbime dezinfektimi për kufizimin e përhapjes dhe mbrojtjen nga virusi COVID-19, krahas shpenzimeve të domosdoshme të funksionimit të institucionit. Ndërkohë, një pjesë e shpenzimeve të planifikuara, për shkak të natyrës së tyre, nuk mund të realizoheshin në kushtet e kufizimit të lëvizjeve për shkak të pandemisë, si shpenzime udhëtimi e dieta dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare. Për pasojë janë krijuar fonde të lira në artikullin 602, “Shpenzime operative” dhe 231, “Investime”. Fondet e lira në shpenzime operative u përdorën nëpërmjet transferimit, në shpenzime personeli, për të plotësuar nevojat në këtë artikull, sikurse shpjegohet në vijim.

Në mënyrë analitike, performanca e realizimit të shpenzimeve për 8-mujorin e vitit 2020, për Institucionin e Komisionerëve Publikë, paraqitet në vijim:

Realizimi i buxhetit sipas artikujve buxhetorë

Në mijë lekë

Emërtimi	Buxheti vjetor	Buxheti vjetor i rishikuar	Buxheti, plani 8 - mujor	Realizimi 8 - mujor	Realizimi në %
Paga dhe sigurime 600+601	57,000	57,000	40,800	40,257	98.7%
Shpenzime për mallra dhe shërbime, dhe fondi i veçantë 602+606	9,200	8,900	5,950	1,490	25%
Shpenzime kapitale 231	1,000	1,000	1,000	118	11.8%
TOTALI	67,350	67,050	47,750	41,865	87.7%

- 1. Artikulli 600 dhe 601, “Shpenzime personeli”,** buxheti vjetor i alokuar në fillim të vitit 2020 për këtë zë është 57,000 mijë lekë, buxhet i cili nuk mbulon nevojat e institucionit për

të gjithë vitin, parashikuar kjo dhe gjatë hartimit të projektbuxhetit për vitin 2020, si dhe reflektuar në detajimin mujor të buxhetit. Për këtë arsye është kërkuar transferim fondi nga shpenzimet operative në shpenzime për paga, i cili është miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në muajin shtator. Gjithashtu është paraqitur kërkesa për fond shtesë për plotësimin deri në fund të vitit të të gjithë nevojave në shpenzime personeli.

Buxheti i akorduar në shpenzime personeli për periudhën janar - gusht 2020, për 30 punonjësit e institucionit, sipas strukturës së miratuar në Vendimin e Kuvendit nr.102/2018, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin e Kuvendit nr. 94/2017, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionerëve Publikë”, si dhe për 2 punonjës me kontratë, është në vlerën 40,800 lekë. Realizimi i këtij buxheti është në nivelin 98.7%.

- 2. Artikulli 602, “Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera”**, buxheti i miratuar në fillim të vitit në këtë artikull ishte 9,200 mijë lekë. Gjatë 4-mujorit të parë të vitit ky buxhet është rishikuar me Aktin Normativ nr.15, datë 15.4.2020, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, duke u pakësuar me 300 mijë lekë dhe arritur në vlerën 8,900 mijë lekë.

Për 8-mujorin e vitit 2020, buxheti i planifikuar në këtë zë është në vlerën 5,950 mijë lekë dhe performanca e realizimit të tij është 25%. Në këtë nivel të realizimit të buxhetit ka ndikuar, siç u citua më lart, kufizimi i shpenzimeve sipas udhëzimeve të MFE-së dhe APP-së, për shkak të pandemisë COVID-19. Procedurat e prokurimit të parashikuara për t’u finalizuar në muajin mars, “Blerje kancelarie” dhe “Shërbim i licencimit të *Firewall-it*”, u pezulluan në fazën e marrjes në dorëzim, në mbështetje të këtyre udhëzimeve, si dhe në zbatim të urdhrin të Komisionerëve Publikë për vijimin e punës *online*, në zbatim të akteve ligjore dhe mbrojtjes së jetës së punonjësve. Këto procedura u finalizuan në muajin maj, me rifillimin e aktivitetit, duke ndërthurur punën në zyrë me atë *online*. Gjithashtu u realizuan procedurat për shërbimin e dezinfektimit të ambienteve të punës dhe blerjen e materialeve për mbrojtjen e jetës së punonjësve në kuadër të pandemisë COVID-19. Gjatë këtij 8-mujori janë likuiduar kryesisht detyrimet mujore për energji, ujë, postë, telefon, në përmbushje të angazhimeve kontraktuale, me miratimin e MFE-së. Në vijim, me mbarimin e gjendjes së jashtëzakonshme, rifilloi kryerja e shpenzimeve normale për zhvillimin e aktivitetit të institucionit.

Sikurse shpjegohet në nisje të këtij relacioni, në kushtet e pandemisë COVID-19, Institucioni rivlerësoi nevojat në shpenzime operative, duke i reduktuar ato në nivelin minimal të shpenzimeve më të domosdoshme për funksionimin e aktivitetit, kryesisht shpenzime për materiale dhe pajisje, dhe shërbime dezinfektimi për kufizimin e përhapjes dhe mbrojtjen nga virusi COVID-19, krahas shpenzimeve të domosdoshme të funksionimit të institucionit. Ndërkohë, një pjesë e shpenzimeve të planifikuara, për shkak të natyrës së tyre, nuk mund të realizoheshin në kushtet e kufizimit të lëvizjeve për shkak të pandemisë, si shpenzime udhëtimi e dieta dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare. Gjithashtu, kufizimi i veprimtarisë institucionale, në 4-mujorin e parë, në kushtet e shtëpisë, për shkak

të akteve ligjore e nënligjore gjatë pandemisë, solli reduktim të disa shpenzimeve për materiale të përgjithshme zyre.

Një arsye tjetër e mosrealizimit të fondit në këtë zë, ka qenë nevoja për ekonomizim të tij, me qëllim transferimin në artikullin 600, "Paga", të fondit të nevojshëm për plotësimin e detyrimeve vjetore për paga dhe sigurime shoqërore, për 30 punonjësit e institucionit. Sikurse jeni vënë në dijeni, buxheti i akorduar në shpenzime personeli për vitin 2020 ka qenë i pamjaftueshëm për realizimin e pagesave për muajin dhjetor 2020. Me miratimin tuaj u transferua fondi 3,500 mijë lekë, nga shpenzime operative në shpenzime personeli, i cili teknikisht është alokuar në muajin shtator, por praktikisht i përket kursimeve të periudhës 8-mujore. Nëse do të merrnim në konsideratë këtë transferim, realizimi i buxhetit për periudhën 8-mujore do të ishte në masën 61%.

3. Artikulli 231, "Shpenzime kapitale", buxheti i miratuar për këtë artikull për vitin 2020 është 1,000 mijë lekë. Gjatë 8-mujorit nuk ka pasur rishikime të tij dhe buxheti i planifikuar për këtë periudhë është 1,000 mijë lekë, buxhet i cili është realizuar në nivelin 11.8% ose 118 mijë lekë. Shpenzimet kapitale administrative janë realizuar duke plotësuar nevojat për barriera mbrojtëse, në vendet e punës së punonjësve, për kufizimin e rrezikut nga virusi COVID-19. Situata e Pandemisë ka pasur ndikimin e vet edhe në realizimin e këtij buxheti. Nga ana jonë, në komunikim me MFE-në, në kuadër të solidaritetit me situatën, u kemi vënë në dispozicion për pakësim 80% të këtij buxheti.

Në përfundim, dëshirojmë të theksojmë se buxheti i vitit 2020 është zbatuar në përputhje me dispozitat ligjore, duke respektuar prioritetet e MFE-së për kryerjen e shpenzimeve, dhe synuar një performancë të mirë të realizimit të fondeve buxhetore në të gjithë zërat e shpenzimeve.

Nëpunës Zbatues

Adelina Kastrati



Nëpunës Autorizues

Alketa Çeli

ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit		Komisioneret Publike				Kodi i Grupit		63	
Programet		Shpenzimet e Institucionit							
Titulli	Emertimi	(1) Fakti i vitet paraardhes Viti 2019	(2) PBA Viti 2020	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2020	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2020	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes 8 mujore /progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca	
0001	Programi 03360	69,518	77,400	67,350	67,050	47,750	41,865	-5,885	
Totali i Shpenzimeve te Institucionit		69,518.00	77,400	67,350	67,050	47,750	41,865	-5,885	
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit					-				
Totali		69,518	77,400	67,350	67,050	47,750	41,865	-5,885	

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	30.09.2020		Data	30.09.2020

ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"

ne 000/leke


Emri i Grupit	Komisionerët Publikë						Kodi i Grupit	63
Programi	Veprimtaria e Komisionerit Publik						Kodi i Programit	03360
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)
		Fakti i vitit paraardhës Viti 2019	PBA Plan 2020	Buxheti Vjetor Viti Plan Fillestar viti korrent 2020	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2020	Buxheti Vjetor Plani i Periudhes 8 mujore /progresiv	Fakti i Periudhes/progresiv	Diferenca
600	Paga	58,540	60,200	51,500	51,500	36,800	36,292	-508
601	Sigurime Shoqërore	5,920	6,200	5,500	5,500	4,000	3,965	-35
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	3,643	10,000	9,200	8,900	5,800	1,490	-4,310
603	Subvencione							0
604	Transferta Korente të Brendshme							0
605	Transferta Korente të Huaja							0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	60		150	150	150		-150
Nen -Totali	Shpenzime Korrente	68,163	76,400	66,350	66,050	46,750	41,747	-5,003
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara	1,356	1,000	1,000	1,000	1,000	118	-882
232	Transferta Kapitale							0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	1,356	1,000	1,000	1,000	1,000	118	-882
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara							0
232	Transferta Kapitale							0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0	0	0	0
Totali	Shpenzime Kapitale	1,356	1,000	1,000	1,000	1,000	118	-882
Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti							0	
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		69,519	77,400	67,350	67,050	47,750	41,865	-5,885


Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	30.09.2020		Data	30.09.2020

ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te tregesve te performances/produkteve te programit"

Emri i Grupit	Komisionerët Publikë	63
Programi	Veprimtaria e Komisionerit Publik	3360

Kodi	Emertimi i Tregesit te Performances/Produktit	Njësia matese	ne 000/leke		I		II		III		IV		Luhatjet ne Koston per Njesi			Komente		
			Sasia Faktike (sipas vitit 2019)	Shpenzimet (sipas vitit 2019)	Kosto per Njesi (sipas vitit 2019)	Sasia (sipas planit te vitit 2020)	Shpenzimet (sipas planit te vitit 2020)	Kosto per Njesi (sipas planit te vitit 2020)	Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit 2020)	Shpenzimet (sipas planit te rishikuar te vitit 2020)	Kosto per Njesi (sipas planit te rishikuar te vitit 2020)	Sasia Faktike per 8 mujorin e vitit 2020	Shpenzimet Faktike per 8 mujorin e vitit 2020	Kosto per Njesi per 8 mujorin e vitit 2020	V = IV - I		V = IV - II	V = IV - III
Produkti 1	Numer Çeshtjesh te njoftuara nga KPK, te shqyrtuara nga Komisioneret Publike brenda afateve ligjore	nr. Çeshtjesh	128	68,163	533	130	66,350	510	130	66,050	508	63	41,747	663	24%	30%	30%
Produkti 2	Pajisje komp/mobile/pajisje zyre	sete pune	10	1,356	136	9	1,000	111	9	1,000	111	1	118	118	-13%	6%	6%
Totali				69,519	668	139	67,350	621	139	67,050	619	64	41,865	781				0


Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati
	Firma	
	Data	30.09.2020

Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma	
	Data	30.09.2020

ANEKSI nr.4 "Raporti i realizimit te objektivave te politikës se programit"

Periudha e Raportimit: 8 mujori 2020


Kodi i Programit	3360	Emertimi i programit:							Komente
Qellimi 1	Procesi i Rivleresimit te gjyqtareve dhe prokuroreve ne Republiken e Shqiperise ka per qellim garantimin e e funksionimit te shtetit te se drejtes, pavaresine e sistemit te drejtesise si dhe rikthimin e besimit te publikut tek institucionet e ketij sistemi	Vepimtaria e komisionerit Publik							
Objektivat e politikës:		Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Niveli faktik i vitit 2019	Niveli i planifikuar ne vitin 2020	Niveli i rishikuar per 8 mujorin e vitit 2020	Niveli faktik per 8 mujorin e vitit 2020	% e realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
Objektivi 1.1	Mbrojtja e interesit publik gjate kryerjes se procesit te rivleresimit, respektimi i parimit te paanesise dhe pavaresise, procesit te regullt ligjor, transparences dhe frymes se bashkepunimit ndermjet dy komisionereve publike, Operacionit Nderkombetar te Monitorimit dhe institucioneve te tjera."								
	Numer Çeshtjesh te njoftuara nga KPK, te shqyrtuara nga Komisioneret Publike brenda afateve ligjore	A	Shqyrtim i vendimeve te njoftuara nga KPK	128	130	130	63	48%	

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizus	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	30.09.2020		Data	30.09.2020

ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"

Projektet me financim te brendshëm (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti i Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2020	Realizimi Progresiv nga fillimi i vitit 2020	Realizimi për periudhën e raportimit vjetor	Realizimi Progresiv nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
M630002	Pajisje dhe mobilje zyre	450	2020	2020		450	118	118	118	
M630013	Pajisje kompjuterike	550				550	-	-	-	
TOTALI		1,000			-	1,000	118	118	118	-

Nepunesi Zbatues			Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizus		
	Emri	Adelina Kastrati		Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	30.09.2020		Data	30.09.2020

